




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 12 dhe 34 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/08 Për marrëveshjet e bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urban, si dhe nenit 14 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës 30.04.2015, pas shqyrtimit të propozim Rregullorës së Kryetarit të Komunës miratoi këtë

**RREGULLORE
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR BASHKËPUNIMIN E
KOMUNËS DHE ORGANIZIMIN E FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE
URBANE**

Neni 1

Me këtë Rregullore ndryshohet neni 7, 12 dhe 16 i Rregullores për bashkëpunimin e Komunës dhe organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane Nr.15 -011-45599 i datës 12.11.2014

Neni 2

Pika 8 e nenit 7 fshihet dhe zëvendësohet me përmbajtjen si vijon:

”8. Kryetari i këshillit zgjedhet në mes të anëtarëve të këshillit i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim. Nëse në rrethin e parë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e votave atëherë organizohet rrethi i dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për kryetar të këshillit në mandat prej 4 viteve.”

Neni 3

Pika 1 e nenit 12 të Rregullorës riformulohet si në vijim:

”Kuorumin e përbëjnë Tubimi i qytetarëve të cilët marrin pjesë në zgjedhjen e Këshillit dhe Kryetarit të fshatit, vendbanimit, lagjeve urbane.”

Neni 4

Në nenin 16, pas pikës 5.7 shtohet një paragraf i ri me përmbajtje si vijon:
“5.8 Numrimi i votave bëhet në mënyrë publike para pjesëmarrëve në tubimin zgjedhor.”

Neni 5

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës.

15Nr. 011 - 23127
Lipjan 06-05 2015

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJAE KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

